



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtoria i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë/Datum/ Date:	12.05.2025
Për/Za/For:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit
Nga/Od/From	z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
Lënda/Subjecat/Subject:	Raporti për muajin Prill

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë për periudhën nga 01.04.2025 deri me 30.04.2025

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Gjatë muajit Prill, Drejtoria e Bujqësisë ka vazhduar me zbatimin e aktiviteteve të planifikuara në përputhje me objektivat e sektorit, me qëllim të përmirësimit të kushteve për fermerët, zhvillimit të bujqësisë dhe avancimit të praktikave të qëndrueshme rurale.

Në fillim të muajit, janë iniciuar procedurat e prokurimit për pajisje dhe mekanizëm bujqësor, duke përfshirë:

- Frezë dheu për traktor
- Spërkatëse me kapacitet 400 litra
- Shpërndarës plehu mineral me kapacitet 350 litra

Po ashtu, është bërë thirrjen për aplikim për fermerët për këto pajisje, e cila ka qenë e hapur për një periudhë 15-ditore. Këto aktivitete janë realizuar në përputhje me planifikimet vjetore të drejtorisë.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka hapur programin për pagesa direkte dhe digjitalizimin e sipërfaqeve të mbjella me kultura të ndryshme bujqësore. Edhe pse afati për aplikim është shtyrë deri më 19 maj, Drejtoria ka përfunduar me sukses regjistrimin e 1700 fermerëve përfitues brenda muajit Prill. Ky angazhim reflekton efikasitetin dhe përkushtimin tonë në përkrahje të fermerëve lokalë.

Janë vazhduar punimet për përmirësimin e infrastrukturës përmes zhavorrimit të rrugëve fushore. Ky proces është zhvilluar në disa lokalitete, bazuar në kërkesat dhe nevojat konkrete të fermerëve, duke përmirësuar kështu qasjen dhe qarkullimin për aktivitetet bujqësore.

Në bashkëpunim me organizatën Qatar Charity, është vazhduar implementimi i projektit për hapjen e puseve të ujit për familjet në nevojë që përballen me mungesë të ujit të pijshëm. Deri më tani, puna ka treguar rezultate shumë të mira, dhe shpresojmë në vazhdimësinë e projektit në zona të tjera që kanë nevojë për këtë ndërhyrje të domosdoshme.

Komisioni i krijuar me vendim të kryetarit për verifikimin e dokumentacionit për subvencionimin e sektorit të blegtorisë ka përfunduar punën me sukses. Gjatë kësaj periudhe, kanë aplikuar gjithsej 56 fermerë blegtorë për subvencionimin e prodhimit të qumështit. Komuna e Lipjanit, përkatësisht Drejtoria e Bujqësisë, do të subvencionojë me 0.04 euro për litër, për këtë vit kemi rritje të sasisë së dorzuar të qumështit prej 202,000 litrash më shumë se vitin paraprak. Ky është një tregues i qartë i rritjes së prodhimit dhe zhvillimit pozitiv të sektorit të blegtorisë.

Gjatë këtij muaji ka përfunduar montimi i 100 serave me sipërfaqe nga 100 m² për familjet përfituese. Këto sera do të kontribuojnë ndjeshëm në zhvillimin e bujqësisë intensive dhe prodhimit dhe perimeve, duke u ofruar familjeve përfituese një mundësi të re për vetëpunësim dhe sigurim të të ardhurave.

Aktualisht jemi në fazën përfundimtare të shpërndarjes së 88 motokultivatorëve, të cilët janë përfshirë në listën e pritjes. Me anë të këtij subvencioni synojmë të lehtësojmë punën e fermerëve të vegjël dhe të nxisë përdorimin e mekanizimit në bujqësi.

Gjatë muajit Prill është filluar një fushatë për trajtimin dhe kontrollin e qenve endacakë, duke përfshirë kryesisht lagjet e qytetit dhe zonat periferike. Kjo iniciativë paraqet një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të kushteve të jetesës për qytetarët, si dhe përkujdesjes ndaj kafshëve.